



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:227897
Datë: 21.11.2024
Numri i dokumentit: 06484156

A.nr.1859/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtare, Luljeta Maxhuni, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditësit, R.H. nga fshati K..., komuna e D..., kundër të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, me bazë baza juridike, anulimi i aktit kontestues, në seancën e shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në mungesë të palëve ndërgjyqës, më datë 06.11.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. Refuzohet, kërkesëpadia e paditësit, R.H. nga fshati K..., komuna e D..., me të cilën kanë kërkuar që të anulohet vendimi e të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, të datës 01.08.2023 me numër të dosjes 3773220, dhe ti njihet e drejta e kompensimit e pensioneve mënyrë retroaktive në shumën prej 500 euro, si e pabazuar.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës

A r s y e t i m i

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA-së, në mungesë të palëve ndërgjyqës të ftuar në mënyrë të rregullt gjyqësor.

Paditësi ne padinë e parashtruar pran kësaj gjykate ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia si e bazuar dhe të anulohet vendimi e të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, të datës 01.08.2023 me numër të dosjes 3773220, dhe ti njihet e drejta e kompensimit e pensioneve mënyrë retroaktive në shumën prej 500 euro si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës.

E paditura me përgjigje në padi të datës 02.09.2024 dhe në parashtrësën të parashtruar në këtë gjykatë me datën 29.10.2024, e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar duke theksuar se kërkesëpadia e paditësit është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi respektivisht në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ nr.05/2015, pasi që paditësi nuk ju ka përmbajtur rregullave ligjore, andaj edhe janë suspenduar nga pagesa, andaj i propozon gjykatës që pas administrimit të provave të refuzohet kërkesëpadia si e pa bazuar dhe të mbeten në fuqi vendimi kontestues i të paditurës.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesore të mbajtur me datë 06.11.2024, ka bërë administrimin e provave dhe atë: vendimi i dt.08.05.23, vendimi dt.27.07.22, vendimi i dt.01.08.23, dokumentet mjekësore prej 11 f, ankesa e dt.13.07.23, kopja e letërnjoftimit e dt.15.05.2019, kërkesë për pensionin bazë 24.04.23, vendimi i dt.20.05.22, regjistrimi i aplikantit për pension i dt.10.05.22, kërkesë për pension dt.10.05.22, qarkullimi BPB dt.10.05.22, ekstrakti nga regjistri qendror i dt.04.05.22, certifikata e dt.04.05.22, fatura e tatimit në pronë e dt.04.05.22, fatura KES CO dt.27.04.22, vendimi i dt.13.07.22.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në shqyrtimin kryesor, duke vlerësuar vet gjendjen faktike, vendosi në mënyrë meritore dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Me vendimin e të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, i datës 01.08.2023 me numër të dosjes 377320, paditësit ju është refuzuar ankesa si e pa bazuar për kompensimin e pensioneve të pa paguara ngase nuk janë respektuar procedurat ligjore për lajmërim të pensionistëve dy herë në vit përkatësisht çdo 180 ditë brenda vitit kalendarik me arsyetimin se nuk i kanë respektuar afatet ligjore për lajmërimin e pensionistëve ashtu siç është paraparë me parafin 2 të nenit 4 të Udhëzimit Administrativ 05./2015 për Procedurat Lajmërimin Suspendimit, Riaktivizimit dhe Ri-aplikimit, gjegjësisht nuk kanë lajmëruar se a janë të sëmur apo njoftuar zyrtaret kompetent se brenda një periudhe të caktuar mund të mos paraqitet për vazhdimin e pagës së pensionit për arsye të ndryshme, andaj, në këtë kuptim komisioni për ankesa ka konstatuar se kërkesa për kompensimin e pagës së pensionit është e pa bazuar ngase pala nuk ju është përmbajtur afatit për lajmërim andaj refuzohet ankesa si e pa bazuar.

Për të vendosur në këtë mënyrë, gjykata iu referua fillimisht Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 05/2015 për Procedurat e Lajmërimin, Suspendimin nga Pagesa dhe Kthimin e Mjeteve në Rastet e Keqpërdorimit të Pensioneve, konkretisht nenit 4 par.2 i cili përcakton se: *“Shfrytëzuesit e pensionit janë të obliguar që të lajmërohen personalisht çdo 6 muaj përkatësisht 180 ditë, në zyrat më të afërta të Departamentit të Pensioneve”*.

Ndërsa neni 5 i këtij udhëzimi përcakton se: “1. Nëse pensionisti nuk lajmërohet siç është përcaktuar në nenin 4 paragrafin 2 të këtij udhëzimi, suspendohet përkohësisht nga pagesa e mëtejme e pensionit. 2. Pensionisti që është suspenduar sipas paragrafit 1 të këtij neni, i vazhdohet pagesa e pensionit, nëse pensionisti lajmërohet në zyrën përkatëse pensionale, brenda tre (3) muajsh nga data e suspendimit. 3. Në rast se pensionisti, lajmërohet brenda tre (3) muajve nga data e suspendimit, duke llogaritur muajin e lajmërimit, Departamenti i Pensioneve, përkatësisht zyra e pensioneve, është e detyruar të ia paguajë pensionet e papaguara maksimalisht për tre (3) muaj. 4. Në rast se pensionisti, nuk lajmërohet në afat prej tre (3) muajsh apo nëntëdhjetë (90) ditë, nga data e suspendimit, kërkesa e tij konsiderohet si riaplikim ndërsa pagesa do të rrjedhë nga dita (muaji) e paraqitjes së kërkesës”.

Në bazë të shkresave të lëndës, respektivisht nga ankesa e datës 13.07.2023, konfirmohet nga vet paditësi se, nuk ka mundur të lajmërohet me kohë në Zyrën e Departamentit të Pensioneve për shkak të ekzistimit të rrethanave të arsyeshme për shkaqe shëndetësore, ku edhe është lajmëruar në Zyrën e Departamentit të Pensioneve, e që nga kjo shihet se paditësi ka ri-aplikuar 24.04.2023 dhe pagesa i është realizuar nga data e parashtrimit të kërkesës - ri aplikimit, në këtë kuptim të kësaj komisioni për ankesa ka vepruar drejt kur ka konstatuar se kërkesa për kompensimin të pagesës së pensionit është e pa bazuar ngase paditësi nuk është përmbajtur afatit për lajmimin, kështu që për shkak të moslajmërimit dhe nuk është njoftuar me kohë për shkaqet për moslajmërim andaj është suspenduar me datën 14.11.2022 ku dhe ju është ndërprerë ky pension pas 3 muajve shtesë datë 14.02.2023, derisa lajmërimi i fundit ka qenë me datën 24.04.2023, e që nga kjo vërtetohet se paditësi nuk i ka përfillur afatet ligjore për lajmërimin e pensionistëve ashtu siç është e paraparë me nenin 4 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ 05/2015.

Për më tej, paditësi nuk kanë marr asnjë veprim edhe pasi mund të ketë vërejtur se në llogarinë bankare të tij nuk janë bartur pensionet për disa muaj dhe në këtë kuptim në bazë të nenit 5 të njëjtit Udhëzim fillimisht suspendon nga pagesa, por, përkundër faktit që ju është bërë suspendimi nga pagesa e pensioneve paditësi ka pasur mundësi të lajmërohet brenda tre muajve ashtu siç është paraparë në paragrafin 1 të nenit 5 dhe në bazë të kësaj ti vazhdohet pagesa, mirëpo, edhe pas këtij afati paditësi nuk është lajmëruar, e të cilin fakt e ka cituar edhe në ankesën e datës 13.07.2023, andaj në bazë të dispozitave të lartcekura, paditësi nuk ka të drejtë në kompensim në mënyrë retroaktive sipas kërkesëpadisë.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të paditësit dhe gjen se të njëjtat në këtë çështje administrative, nuk kanë ndikim në vendosje tjetër, nga ajo që ka vendosur organi i paditur, sepse me provat e administruara, në kuptim të dispozitave së cekura ligjore, është vërtetuar se paditësi nuk i plotëson kushtet ligjore për njohjen e të drejtës së kërkuar, respektivisht, në kompensimin e pensioneve të lartcekura

mënyrë retroaktive në shumën prej 500 euro respektivisht për 5 muaj, pasi që kërkesën për pagesën e pensioneve e kanë bërë pas afatit të paraparë ligjor, andaj nga kjo është e pa bazuar.

Nga kjo, gjykata vlerëson se vendimi kontestues është i drejt dhe të bazuar në ligj dhe se organi i paditur, drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, kur ka refuzuar ankesën e paditësit. Mbi këto arsye kërkesëpadinë e paditësit nuk e aprovoi, sepse sipas vlerësimit të gjykatës, nuk është cenuar ligji në dëm të paditësve.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 64 të LKA-së, me të cilin është përcaktuar që “Në konfliktin administrativ secila palë t’i bartë shpenzimet e veta.”

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43.3, 46.2, 5 lidhur me nenet 5, 6, 38 dhe 67 Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 63 e lidhur me nenin 21 Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin Ligjit, Nr.03/L-006 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr.1859/2023- data: 06.11.2024

Gj y q t a r j a

Luljeta Maxhuni

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.